

E njëjte me origjinalin
KANCELAR
Bleris Murya




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr.1241/ 870 regjistri, datë 8.8./ 1.9.2014.

Nr.882 vendimi, datë 23.10.2015.



V E N D I M

NË

“EMËR TË REPUBLIKËS”

Unë **Ahmet JANGULLI/ GJYQTAR** në gjykatën administrative të shkallës së parë Shkodër, në Shkodër në datën **23.10.2015**, shqyrtova në seancë përkatëse çështjen administrative nr.1241/ 870 akti, që u përket palëve :

Paditëse :

Shoqëria “GIO & SHOES” sh.p.k., e identifikuar me Nipt in K86621031V, me seli Shkodër Shkodër SHKODËR Lagjia “Skënderbeg”, nr.9, me status **Pezulluar**.

Me përfaqësues ligjor z. Gjovalin Vasa (ekstrakti i QKR së, akti në fashikull).

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr. prot datë 5.8.2014, nga z. Angjelin Vasa/ i njohur me letërnjoftimin me nr.028892296 e me nr. personal F31124033R.

Të paditur :

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr.7612 prot datë 18.9.2014, nga juristja zj Sirjana Bakushi/ e njohur me letërnjoftimin me nr.024589376 e me nr. personal H75426117F.

Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë.

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr.24644/ 1prot datë 23.9.2014 të drejtorisë së përgjithshme të Tatimeve, nga juristja zj Sirjana Bakushi/ e njohur me letërnjoftimin me nr.024589376 e me nr. personal H75426117F (tagër me cen, pasi nuk ka identifikuar juristin përkatës, dhe për më tepër që ky i fundit nuk është punonjës i dpt së).

Objekti :

Kundershtim i shkresës nr.13961/3 prot datë 7.7.2014 e Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë “Dergohet vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimore” për refuzimi të ankimit për “Rimbursimin e kamatvonesave në likuidimin e TVSH-së” dhe shkresa nr.3248/1 datë 13.5.2014 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër “Kthim pergjigje”, shkresës së subjektit “GIO&SHOES” sh.p.k të datës 6.5.2014:

“Për mospranimin për likuidimin e plotë të demit financiar të shkaktuar subjektit “GIO&SHOES” sh.p.k, për Shumen prej 235.625 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë që përbëhet nga:

1. Kamatvonesat e llogaritura në vlerën 133.219 lekë, për likudin me vonesë të TVSH-së. Llogaritjet janë bërë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi (ligji nr. 7928 datë 27.4.1995 “Për tatimet mbi vlerën e shtuar” me ndryshimet e mëvonshme, neni 53 “Kamatvonesat për rimbursim” germa “b” dhe ligji nr. 9920 datë 15.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 76 “Kamatvonesat”, pika 3 dhe 4, në masën 120% të shkallës së interes nderbankar të bankës së shqipërisë, që përcaktohet cdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.
2. Gjopa të vendosura subjektit në vlerën prej 102.406 lekë, nga mos likudimi i sigurimeve shoqërore, si pasojë e mos rimbursimit në kohë të TVSH-së.

B. Ligjore :

Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”, neni 17.

Ligji nr.7928 datë 27.4.1995 (me ndryshimet e mëvonshme) “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, neni 50 “Rimbursimet”, pika 4, neni 53 “Kamatvonesat për rimbursim”, germa “b”.

Ligji nr.9920 datë 15.5.2008 (me ndryshimet e mëvonshme) “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë”, neni 75/1 “Rimbursimi i TVSH dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, neni 76 “Kamatvonesat”, pika 2 germa “b”, pika 3 dhe 4.

Udhëzimi nr. 24 datë 2.9.2008 (me ndryshimet e mëvonshme) “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 106.1.1-106.1.2, 106.2.4-107.1.

Gjatë gjykimit, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, e si shqyrtova aktet shkresore në tërësi.

KONSTATOVA

I.

1. Se, pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit.

1.1. padia është regjistruar *pa u paguar* taksa mbi aktet/ e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

II. Rrethanat e faktit:

2. Palët me njeri tjetrin, janë në një konflikt, për veprimet administrative të kryera gjatë mbajtjes së akteve dhe gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ.

2.1. pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit të mësipërm, duke paraqitur para gjykatës/ **padinë e mësipërme** (bëhet fjalë për padinë e

paraqitur për regjistrim), dhe duke mos i bashkëngjitur asaj/ asnjë lloj akti (aktet shkresore përkatëse, aktet në fashikull).

2.2. pala paditëse ka paraqitur aktin që është marrë gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ, që ka shqyrtuar aktin administrativ (aktin administrativ, që ka sjellë pasojën (ndike)), por nuk ka paraqitur vetë këtë të fundit (aktet në fashikull).

2.2.1. aktet shkresore që i janë bashkëngjitur padisë (edhe akti që është marrë gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ, që ka shqyrtuar aktin administrativ), **janë paraqitur thjesht e vetëm në fotokopje, duke i hequr mundësinë gjykatës, për t'i marrë në shqyrtim** (për më tepër, aktet, në fashikull).

2.3. padia është hartuar në gjashtë fletë formati A-4, dhe pala paditëse/ është paraqitur para gjykatës, duke kërkuar:

“Kundershtim i shkresës nr.13961/3 prot datë 7.7.2014 e Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë “Dergohet vendimi I Drejtorisë së Apelitit Tatimore” për refuzimi të ankimit për “Rimbursimin e kamatvonesave në likuidimin e TVSH-së” dhe shkresa nr.3248/1 datë 13.5.2014 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër “Kthim pergjigje”, shkresës së subjektit “GIO&SHOES” sh.p.k të datës 6.5.2014:

“Për mospranimin për likuidimin e plotë të demit financiar të shkaktuar subjektit “GIO&SHOES” sh.p.k, për Shumen prej 235.625 (dyqind e tridhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë që përbëhet nga:

1. Kamatvonesat e llogaritura në vlerën 133.219 lekë, për likudin me vonesë të TVSH-së. Llogaritjet janë bërë sipas percaktimeve ligjore në fuqi (ligji nr. 7928 datë 27.4.1995 “Për tatimet mbi vlerën e shtuar” më ndryshimet e mëvonshme, neni 53 “Kamatvonesat për rimbursim” germa “b” dhe ligji nr. 9920 datë 15.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 76 “Kamatvonesa”, pika 3 dhe 4, në masën 120% të shkallës së interes nderbankar të bankës së shqipërisë, që percaktohet cdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.

2. Gjoha të vendosura subjektit në vlerën prej 102.406 lekë, nga mos likuidimi i sigurimeve shoqërore, si pasojë e mos rimbursimit në kohë të TVSH-së.” (**objekti i padisë**);

“Asnjë lloj kërkimi konkret” (**arsyetimi i padisë**);


dhe,

“Asnjë lloj kërkimi konkret” (**kërkimi në fund të padisë**).

2.3.1. në kërkimin që trajton padia e mësipërme, me atë objekt padie, me parashtrimin në arsyetimin e saj, dhe me kërkimin e konkluduar që trajton padia, nuk mund të konceptohet se çfarë po kërkon pala paditëse, në raport me veprimet administrative të kryera nga pala e paditur dhe ja Shkodër, në raport me aktin administrativ objekt gjykimi, duke konsideruar ligjin procedural (ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe k.pr.civile).

3. Çështja (padia) është paraqitur për gjykim në datën 8.8.2014/ nëpërmjet shërbimit postar. Në zbatim të ligjit procedural civil – administrativ/ gjykata ka vendosur që të regjistrohet

padia e bashkë me regjistrimin të paguhet edhe taksa mbi aktet e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.



4. Në datën 23.9.2015/ çështja ka kaluar për veprime përgatitore, duke thirrur edhe palët për t'i dëgjuar.

4.1. në seancë, pala e paditur/ dpt ja, nuk u paraqit/ pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ndonëse kishte dijeni të rregullt, dhe në këto rrethana gjykimi u zhvillua në mungesë të saj.

4.2. në veprimet përgatitore/ në seancën e datës 23.9.2015, kërkesëpadia i është kthyer palës paditëse për t'a plotësuar atë në elementët e saj, sipas vendimit kthim për plotësim të datës 23.9.2015/ duke i lënë një afat kohor prej 10 ditësh, dhe për këtë arsye u ndërpreu veprimet përgatitore. Në këtë vendimmarrje gjykata ka qenë në unison të plotë edhe me vullnetin e palës paditëse, "duke gjetur mirëkuptim në orientimin që u dha nga gjykata në seancë/ e në kohën që u la për të plotësuar padinë në të metat e saj" (për më tepër p-v i seancës dhe vendimi kthim për plotësim).

5. Për vendimmarrjen e mësipërme/ pala paditëse ka marrë dijeni në datën 23.9.2015, dhe në afatin që i është lënë në vendimmarrje (apo edhe deri në seancë, gjë e cila nuk ka asnjë ndikim, por thjesht po e themi si fakt, pasi afatet duhen respektuar), nuk ka paraqitur para gjykatës/ padi të plotësuar në elementët e saj.

5.1. pala paditëse nuk ka kërkuar asgjë para gjykatës, duke pretenduar vetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

5.2. në rrethanat e mësipërme, çështja ka kaluar përsëri për veprime përgatitore, pa i thirrur palët për t'i dëgjuar.

6. *Kërkesëpadia është po ajo që ishte, pala paditëse nuk ka plotësuar asgjë në të, atë çfarë i ishte kërkuar si më sipër, dhe afati që i ishte lënë për plotësim ka kaluar.*

III. Legjislacioni i zbatueshëm:

7. Kodi i Procedurës Civile:

Neni 14

Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Neni 154

Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

...

Neni 156

Aktet që i bashkëngjiten padisë

Bashkë me kërkesëpadinë duhet të paraqiten:

...

8. **Ligji nr.49/2012** "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative":

Neni 21

Padia dhe aktet që i bashkëlidhen

1. Padia duhet të plotësojë kërkesat e neneve 154 e 156 të Kodit të Procedurës Civile.

...

9. **Vendimi i njësuar nr.9 datë 9.3.2006** i kolegjeve të bashkuara të gjykatës së Lartë/ në të cilin është parashikuar:

"...

Në përfundim, mund të theksojmë se neni 154 i K.Pr.Civile përcakton në mënyrë analitike elementët përbërës të kërkesëpadisë si mjeti procedural që vë në lëvizje gjykatën për fillimin e gjykimin të një çështjeje civile. **Një kërkesë padie që nuk i plotëson këto elementë të domosdoshëm është e papranueshme për t'iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, prandaj i kthehet paditësit për t'u plotësuar në respektim të rregullave procedurale."**

10. E drejta/ materiale e procedurale, civile - administrative, në të cilën është parashikuar :

IV. Vlerësimi i gjyqtarit:

11. Në vlerësimin tonë:

11.1. kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor, është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (neni 3/ për nenet 154 e 156 të k.pr.civile). Të njëjtën gjë citon edhe praktika gjyqësore e gjykatës së Lartë (po përmendim/ vendimin civil nr.768/1 datë 15.9.2011 të gjykatës së Lartë).

11.2. konsiderohet se/ për procesin e filluar, gjykata i ka mbaruar detyrimet e saja/ në drejtim të orientimit të procesit, dhe në drejtim të kohës së duhur që i ka lënë në dispozicion palës që ka vënë në lëvizje gjykatën/ për të plotësuar kërkesëpadinë në të metat e saj.

11.3. kërkesëpadia është e pa plotësuar në elementët e saj, pasi nisur nga gjendja e kërkesëpadisë së paraqitur/ e nisur nga gjendja e saj në seancë, asaj i mungojnë:

"të dhënat që duhet të përmbajë/ e që duhet të tregojë, dhe jo më të bëhet fjalë për provat/ aktet provuese që duhet t'i bashkëngjiten asaj" (nenet 154 e 156 të k.pr.civile, dhe neni 21 i ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative").

11.4. në këtë gjendje, gjykata e ka të pamundur që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor e që të japë një zgjidhje të drejtë e përfundimtare për konfliktin/ mosmarrëveshjen midis palëve.

11.5. bashkë me regjistrimin e padisë duhen *paguar* edhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore (nenet 154 e 156 të k.pr.civile).

12. Në këto kushte, e çmova se/ kërkesëpadia duhet t'i kthehet palës paditëse, së bashku me aktet e tjera.

13. Në këtë zgjidhje gjykata është bazuar:

në nenet 42 e 145 pika 1 të kushtetutës së ndryshuar, në nenin 6 të kësaj së, në ligjin nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", e në të drejtën/ materiale e proceduriale, civile - administrative.

Sa sipër provohet me aktet shkresore dhe gjithë dokumentacioni në dosje.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 25 pika 1 gërma a) të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar dhe të nenit 158 gërma a § 1 e 2/ për nenin 154 gërma a § 6/ për § 4 e 5 të k.pr.civile.

V E N D O S A

Kthimin e kërkesëpadisë, në çështjen administrative nr.1241/ 870 akti, datë 8.8./ 1.9.2014, që është ngritur nga pala paditëse shoqëria "GIO & SHOES" sh.p.k., së bashku me aktet.

Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen palës paditëse shoqëria "GIO & SHOES" sh.p.k..

Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë, në gjykatën administrative të apelit Tiranë.

U shpall në Shkodër me 23 tetor 2015.

Shpenzimet gjyqësore :

Njoftime

500 lekë,

Akte – Letër

50 lekë,

Çmimi:

550 lekë.

Pekretare
Entela HASMUTAJ

84



GJYQTAR
Ahmet JANGULLI

PULLE TARIFE



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË 29.12.2015

KANCELARE
BLERTA NURJA

